

## NEWSLETTER - Shtator 2019

### **Studimi Parchemin: ndikimi në shëndet, pas marrjes së lejes së qëndrimit përmes Fushatës Papyrus, kushtet e jetesës dhe gjendja ekonomike e njerëzve migrantë**

Ky studim i vetëm në Evropë është ndërmarr nga Universiteti, Shkollat e larta (les Hautes Ecoles) dhe Spitali Universitar i Gjenevës, nën mbështetjen e zyrave të Caritas-it të Gjenevës, e Qendrës së Kontaktit Suisses-Immigrés (CCSI), e Qendrës Sociale Protestante (CSP), e Qendrës Entraide protestante suisse (EPER), e Unia-s dhe Unionit të Punëtorëve ndërprofesional (SIT). Financohet nga Fondi kombëtar zvicerian për kërkime shkencore. Qëllimi i tij është të ndjekë trajektin e jetës së personave pa leje qëndrimi, i përfshinë gjithashtu disa persona që kanë mundur të rregullojnë lejeqëndrimin e tyre, përmes fushatës Papyrus.

#### **Si po shkon studimi?**

Më shumë se 460 persona iu kanë përgjigjur pyetësorit të parë (viti 1) në 2017-2018 dhe 39 prej tyre morën pjesë në një intervistë të parë të thellësuar. Është një sukses i madh dhe ekipi hulumtues falënderon ngrohtësisht të gjithë pjesëmarrësit dhe shoqatat partnere.

#### **Cilat janë rezultatet kryesore të vitit 1?**




Rezultatet e para u prezantuan në një konferencë më 7 nëntor 2018. Ato janë në dispozicion në internet (<https://www.unige.ch/sciences-societe/socio/fr/recherche/projet-parchemins/symposium-parchemins/>). Vërehet se rregullimi i letrave shoqërohet me një gjendje shëndeti më të mirë dhe një kënaqësi më të madhe në jetë në përgjithësi, por edhe në aspektin e strehimit, të ardhurave dhe punësimit. Njerëzit të cilët kanë marrë një leje qëndrimi, shfaqin më pak shenja ankthi dhe depresioni sesa ata pa leje. Në aspektin profesional, njerëzit me leje kanë më shumë orë pune dhe të ardhura më të mëdha.

#### **Cilat janë etapat e ardhshme?**

Pjesa e ardhshme e studimit do të ndihmojë për të kuptuar dhe shpjeguar më mirë diferencat në aspektin e shëndetit dhe të mirëqenies të vërejtura mes njerëzve të cilëve u është dhënë një leje qëndrimi përmes fushatës Papyrus dhe atyre që nuk iu është dhënë qasje në këtë fushatë. Për momentin jemi duke kontaktuar prap pjesëmarrësit për t'i ftuar ata t'i përgjigjen një pyetësori të dytë (viti 2). Gati 300 persona tashmë janë përgjigjur dhe qëllimi është që të përfundojmë përmbledhjen e të dhënave deri në fund të vitit 2019. Pjesëmarrësit do të kontaktohen përsëri në vitin 2020 (viti 3) dhe në 2021 (viti 4). Paralelisht, intervistat e thellësuar do të vazhdojnë gjithashtu.

Pjesëmarrja në gjithë studimin është thelbësore, për të kuptuar ndikimin e rregullimit të letrave në kushtet e jetesës ndër vite.

**Nëse keni marrë pjesë në pyetësorin e parë dhe nuk jeni kontaktuar për pyetësorin e dytë**, është e mundur që nuk kemi qenë në gjendje t'ju kontaktojmë, për shembull nëse numri juaj i telefonit ka ndryshuar. Në këtë rast, ju falënderojmë që të na kontaktoni përmes:

- ✓ E-mail : [parchemins@unige.ch](mailto:parchemins@unige.ch)
- ✓  [EtudeParchemins](#)
- ✓   [076 794 55 05](tel:0767945505)

**Ekipi i studimit Parchemins ju falënderon për mbështetjen tuaj  
dhe ju dërgon përhëndetjet e tij më të mira.**